

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesional Alban Beqiri në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]" nr. [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED], avokat nga [REDACTED], kundër të paditurës Komunës së Ferizajt – Drejtoria e Administratës dhe Personelit, të cilën e përfaqëson me autorizim Adem Aliu, në çështjen juridike pagesën e pagave jubilarë dhe shkuarjes në pension, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij si dhe të autorizuarit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me dt. 16.07.2013, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** pjesërisht kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] rr." [REDACTED]" nr. [REDACTED], kundër të paditurës Komunës së Ferizajt – Drejtoria e Administratës dhe Personelit, si e bazuar.

**OBLIGOHET** e paditura që paditësit ti paguaj shumën prej 723€ (shtatëqind e njëzet e tri euro) dhe atë shumën prej 482 € (katërqind e tetëdhjetë e dy euro) në emër të pagesës së dy pagave jubilarë dhe shumën prej 241€ (dyqind e katërdhjetë e një euro) në emër të pagesës së një page për përcjellje në pension, në afat prej 7 ditësh, si dhe shpenzimet e procedurës nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënime të përmbartimit me dhunë.

**REFUZOHET** kërkesa e paditësit në shumë prej 482€ në emër të dy pagave përcjellëse në pension si e pabazuar

### **A r s y e t i m i**

Paditësi ka ushtruar padi me 21.05.2013, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Administratës dhe Personelit, për pagesën e pagave jubilarë dhe përcjelljes në pension.

Paditësi përmes të autorizuarit ka deklaruar se mbetet në tërësi pran padisë dhe kërkesë padisë duke theksuar se sipas dispozitave të kontratës së përgjithshme kolektive e paditura me rastin e pensionimit të paditësit ka qenë e obliguar që të paguaj tri paga mesatare si dhe dy paga jubilarë edhe për kundër kërkesës së paditësit e paditura me dt. 16.05.2013, e paditura e ka refuzuar kërkesën e paditësit me pretekst se paditësit ju ka njohur një pagë mujore, kurse për dy paga jubilarë ju ka refuzuar se kontrata kolektive në nuk ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit i propozoj Gjykatës që si prova të administrohen, vendimet si dhe kërkesa për pagesën e pagave në emër të pensionit.

Në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, në tërësi vërtetohen faktet në bazë të cilave rezulton si e bazuar kërkesë padia dhe obligimi i të paditurës për pagesën e tre pagave me rastin e përcjelljes në pension dhe dy pagave si shpërblim jubilar, e drejtë kjo e përcaktuar në kontratën kolektive, prandaj i propozoj Gjykatës që të aprovon padinë si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, si dhe përmes të autorizuarit ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar, për nga baza juridike, me arsyetim kompensimi i këtyre pagave që e kërkon paditësi nuk është e rregulluar me asnjë ligj në fuqi që rregullon fushën e shërbyesit civil. Paditësi padinë e tij e mbështet në dispozitat ligjore të nenit 42,43 dhe 44 të kontratë kolektive e cila kontratë ka qenë në fuqi prej dt.01.01.2005 deri me dt.31.12.2007, andaj koha kur paditësi ka dalur në pension me dt.20.04.2013 kjo kontratë nuk ka qenë në fuqi . Kjo si e tillë është e paraparë me nenin 6 par.6.4 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin themelor të punës ku thuhet “marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar në kohëzgjatje prej jo më shumë se tre vjet”.

Andaj kërkoj nga Gjykata që ta refuzoj kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.

Nuk është deklaruar për shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë ushtrimin e provave, lexohet Vendimi për refuzimin e kërkesës 01.nr.02-119/32154 e dt.16.05.2013, vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit d01.33/2010 e dt.20.04.2013, autorizimin me të cilin e paditura ka autorizuar [REDAKTUAR] që ta përfaqësoj në këtë çështje juridike.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj edhe e aprovon.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimin në padi nga ana e paditësit se te e paditura ka punuar për një periudhë mbi 40 vjeçare.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të dy pagave jubilarë, në shumën prej 482,00€, si dhe një page për përcjellje në pension në shumën prej 241,00 € ka marr për bazë dy pagat mesatare të paditësit që e ka marr në tre muajt e fundit sa ka qenë i punësuar tek e paditura, e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e pagave

Gjykata me rastin e aprovimit pjesërisht të kërkesë padisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe punëdhënësin Oda Ekonomike e Kosovës, e cila është nënshkruar nga të tri palët dhe në nenin 64 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01. janar 2005, kjo kontratë me asnjë nen të saj nuk është përcaktuar se cila është koha e validitetit në mes palëve. Në pjesën hyrëse të kontratës kolektive thuhet se kontrata kolektive është nxjerr në mbështetje të nenit 6 të Rregullores nr.2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovës, Rregullores nr.2001/36 mb. Shërbimin Civil në Kosovë, çka do të thotë se si bazë për shërbyesit civil është marr Rregullorja 2001/36, e që në bazë të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 3 dhe 5 lidhur me nenin 27 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil (Ligji nr.03/L-147 G.Z.RKS Prishtinë viti

V nr.72/25.06.2010) me të cilën përcaktohet se nëpunësit civil kanë të drejtë për pagesa tjera në rrethana të veçanta, ku neni 22 paragrafi 2.3 i këtij ligji përcakton të drejtën në shpërblim i përvjetorit (jubile) dhe neni 22 paragrafi 2.5 përcakton pagesën në rast të pensionimit, ndërsa Qeveria në bazë të nenit 27 par.2 të këtij Ligji ka pasur për obligim nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij Ligji në afatin prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi i këtij Ligji.

Andaj duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura Gjykata konsideron se deri sa nuk rregullohet në mënyrë tjetër ashtu siç është rregulluar me kontratën e përgjithshme kolektive të Kosovës me nenin 43 dhe 44 të kësaj kontrate, kanë zbatim deri sa me akte nënligjore nuk përcaktohen në mënyrë të saktë pagesat nga neni 22 paragrafi 2 pika 3 dhe 5 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil, pasi është obligim i Ministrisë dhe Qeverisë që të nxjerr aktet nënligjore me të cilat do të zbatoheshin dispozitat me të cilat të punësuarve ju njohur të drejtat, në rastin konkret në pagë jubilarë dhe me rastin e pensionimit.

Në nenin 43 të Kontratës së përgjithshme kolektive për të punësuarit në shërbimin civil është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë. çka do të thotë se në rastin konkret i punësuarit, paditësi, këtë të drejtë e ka pasur në shpërblim të dy pagave jubilarë që në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, pasi e ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim nga ana e të punësuarit.

Në nenin 44 të Kontratës së përgjithshme kolektive, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e fundit, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për tre muajt e kaluar nëse për punëtorin kjo është më e përshtatshme, çka do të thotë se në rastin konkret duke marr për bazë pagën e të punësuarit në shumë prej 241,00€ do të ishte më e përshtatshme për punëtorin që të merret dy pagat mesatare të paditësit për tre muajt e kaluar tek e paditura.


Pretendimet e të autorizuarit të paditurës se kontrata kolektive ka qenë në fuqi prej dt. 01.01.2005 deri më 31.12.2007, Gjykata këtë pretendim e konsideron si jo të arsyeshëm dhe jo me bazë ligjore pasi që, Kontrata e përgjithshme kolektive nuk ka përcaktuar ndonjë afat për të cilin do të pushoj së vepruari, por edhe nën supozimin se kjo kontratë do të kishte vlefshmërinë e saj për tri vite këtë të drejtë paditësi e realizon me nenin 22 paragrafi 2 pika 3 dhe 5 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil.

Gjykata nuk gjeti bazë për aprovimin e pagës së dy pagave përcjelljes në pension të paditësit dhe kërkesën e tillë ia ka refuzuar si të pabazuar, ngase në bazë të nenit 44 të kontratës kolektive thuhet: Punëtori ka të drejtë, me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi të dy pagave minimale mujore të punëtorit në Kosovë për tre muajt e kaluar, gjegjësisht dy paga mesatare të punëtorit për tre muajt e kaluar, nëse për punëtorin kjo është më e përshtatshme.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti ne nenin 452.1 të LRK-së duke ua njohur paditësit shumën 249€ dhe atë për padi 78€, përfaqësim në një seancë 121€, taksën gjyqësore për padi 20€ dhe për përpilim të aktgjykimit 20€

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,  
C.nr.349/13 dt. 16.07.2013**



**Gjyqtari,  
Enes Mehmeti**

**KESHILLA JURIDIKE**, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.



→ CA.nr. 3193/2013

Republika e Kosovës / Republika Kosovo  
SAKËTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAKËNOST OTPRAVKA POTVRDIJE

Punëtori i autorizuar  
Otvoreni radnik

*[Signature]*